

**VENDIM**  
**Nr.280, datë 16.4.2004**

**PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË DURRESIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujëtin dhe kullimin”, me propozimin e Ministrisë të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Durrësit, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit.
  2. Zona e shërbimit të kullimit të këtij bordi përbëhet nga:
    - a) zona e fushës Hamallaj (DRK-1), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1770 ha;
    - b) zona e fushës së Kënetës së Durrësit dhe Shkozetit (DRK-4,11), që kullon me ngritje mekanike me hidrovor, me sipërfaqe 3700 ha;
    - c) zona e fushës së Sukthit, Tarinit, Armadhit, Topanasë dhe Rushkullit (DREK-2,3,6,8,9), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 4710 ha;
    - ç) zona e fushës Shënavlash, Fllakë, Katund i Ri (DRK-5, 14), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 3500 ha;
    - d) zona e fushës së lumit Erzen (DKR-7), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 1000 ha;
    - dh) zona e fushës Metallaj, Maminas (DRK-10), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 700 ha;
    - e) zona e fushës Ishëm-Gjuricë (DRK-12, 13), që kullon me rrjedhje të lirë, me sipërfaqe 320 ha;
    - ë) pendët e mbrojtës nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe të kanaleve të ujërave të larta;
    - f) sistemi i mbrojtjes së tokave nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve.
  3. Këshilli i përfaqësuesve të bordit të përbëhet nga:
    - a) 1 (një) përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit;
    - b) 3 (tre) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
    - c) 3 (tre) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
    - ç) 2 (dy) përfaqësues të bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit;
    - d) 1 (një) përfaqësues i këshillit të qarkut;
    - dh) 1 (një) përfaqësues i biznesit, me veprimtari brenda zonës së shërbimit të kullimit.
  4. Anëtarët e këshillit të përfaqësuesve të shpërblehen, çdo muaj, me 5000 (pesë mijë) lekë.
  5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.
  6. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**